REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës Predsednik Opštine
Belediye Başkanı
01 Nr. 481/26 Dt. 19.10.2026

Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), të Rregullores (QRK) nr. 06/2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit, si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit, nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, pas kërkesës së Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M
Për lejimin e udhëtimit zyrtar

1. Miratohet kërkesa e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, për lejimin e udhëtimit zyrtar të Florent Ukaj-drejtor i DUPH dhe Zana Belloda- bashkëpunëtore profesionale në DUPH, për pjesëmarrje në Vizitën Studimore me përfaqësuesit e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, AKM dhe Komunave, e cila do të mbahet nga data 20 tetor 2026 deri me 24 tetor 2026, në Lubljanë të Republikës së Sllovenisë, kështu që, për këtë qëllim lejohet udhëtimi zyrtar, pagesa e mëditjeve, si dhe mbulimi i shpenzimeve të paparashikuara për të lartcekurit, konform akteve ligjore për udhëtimet zyrtare.

2. Kjo vizitë studimore organizohet në bashkëpunim me Asociacionin e Komunave të Kosovës me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë dhe GIZ-it, përmes projektit Kosovo for Green (K4G) të bashkëfinancuar nga Sekretariati Shtetëror Zvizerian për Çështje Ekonomike (SECO) dhe Ministria Federale Gjermane për bashkëpunim ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

3. Shuma e lejuar, e përshkruar si në pikën 1 të këtij Vendimi, do të sigurohet nga buxheti i Komunës - pozicioni i subvencioneve dhe transfereve të Zyrës së Kryetarit dhe Komunës dhe mallrave e shërbimeve të Komunës së Prizrenit.

4. Obligohet Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

➢ Vendimi iu dërgohet:
- Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor,
- Drejtorisë së Ekonomisë dhe Financave,
- Të lartcekurve,
- Arkivës së Kryetarit.